



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Tetor 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Nëntor 2015

Dhjetor 2015

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor 2015

© Ministria e Financave, 2015

Drejtoria e Makroekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [marsed.harizi@financa.gov.al](mailto:marsed.harizi@financa.gov.al)

[eva.doda@financa.gov.al](mailto:eva.doda@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin tetor 2015 arriti në 118.92 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin tetor 2015 ishte 2.1 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin tetor 2015 ishte 124.21 lekë për dollarë dhe 139.53 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit tetor 2015 shënuan kuotat 1.34 për ato 12-mujore, 1.05 për 6-mujoret ,0.67 për qind për depozitat 3-mujore dhe 1.38 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.11 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.81 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1'197'015.1 milionë lekë në muajin tetor, duke shënuar një rritje prej rreth 2.9 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për tremujorin e tretë të 2015-ës rezultoi me një suficit të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-tetor 2015 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 18.2 miliardë lekë, që do të thotë se rreth 40.3% më pak se planifikimi progresiv mujor (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 30.5 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-tetor 2015, arritën në rreth 313.3 miliardë lekë ose afërsisht 97.3 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 331.5 miliardë lekë ose 94 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin tetor 2015 pësoi rritje prej 0.01 për qind krahasuar me muajin shtator 2015, kur ky indeks shënonte rritje prej 0.6 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Gjatë muajit gusht 2015, ky indeks shënoi rritje me 0.8 për qind krahasuar me muajin korrik 2015. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë kanë shënuar rritje me 0.1 për qind për tetor 2014, rritje me 0.3 dhe 0.1 për qind për muajt shtator e gusht 2014.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm prej **+2.1%** në muajin tetor ishin “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +5.5%, duke kontribuar me +2.2 pikë, “Pije alkoolike dhe duhan” me një rritje vjetore të çmimit prej +6.1%, duke kontribuar me +0.2 pikë përqindje dhe “Shërbimi arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje.

Rënia më e madhe gjatë muajit tetor u konstatua në kategorinë “Veshje dhe këpucë”



dhe “Transport” me rënie përkatësisht **-3.7** dhe **-2.1** për qind. Përsa shprehjeve të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këto grupe të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit me nga -0.2 dhe -0.1 pikë përqindje.

Norma vjetore e inflacionit në muajin tetor arriti në 2.1 për qind. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitin 2014 dhe për periudhën janar-tetor 2015 paraqiten në tabelën 1.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2014</b>	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
<b>2015</b>	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2014</b>	1.8	2.0	1.5	1.4	1.7	0.7
<b>2015</b>	1.3	2.0	2.3	<b>2.1</b>		

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin tetor 2015, arriti në 139.52 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.002 për qind me një muaj më parë. Në fund të muajit tetor, një euro u këmbye me 139.18 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin tetor 2015, arriti në 124.2 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.018 për qind kundrejt muajit shtator 2015. Në fund të muajit tetor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 126.43 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin tetor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 13 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar në masën 0.06 për qind. Mbiçmimi i lekut kundrejt monedhës europiane dhe monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i




këmbimit të Euros me Dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare duke mbetur ne nivelin rreth 0.9 dollarë/euro si një muaj më parë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit tetor 2015, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 1.34 dhe 1.05 për qind, duke shënuar rritje respektivisht me 0.07 dhe 0.04 pikë përqindje krahasuar me muajin shtator 2015. Rënie për këtë muaj ka shënuar vetëm norma e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujor duke arritur në nivelin 0.67, duke shënuar rënie prej -0.02 pikë përqindje. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore ku rënia më e madhe prej -0.39 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1- mujor që kanë arritur nivelin 1.38 për qind për tetor 2015.

Fig-3




Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit tetor shënoi rënie me -1.39 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 7.11 për qind krahasuar me muajin shtator 2015. Ndërsa, norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 1.70 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin tetor arriti në 9.81 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, norma e interesit të huave me afat maturimi 12-mujor ka shënuar rritje me 0.34 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 6-mujor janë rritur me 1.95 pikë përqindje.

Fig-4




Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit tetor 2015, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.18, 2.82 dhe 2.57 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore përkatësisht me 0.03, 0.05 dhe 0.04 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për tremujorin e tretë të 2015 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 314.3 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. “Llogaria kapitale dhe financiare” për tremujorin e tretë të 2015 rezultoi të jetë me një deficit prej -378.1 milionë euro.




Kompozicioni i llogarisë korrente prej -325.6 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2015: (i) bilanci tregtar me -608.4 milionë euro, (ii) shërbime neto me 133.8 milionë euro, (iii) të ardhura netome -23.1 milionë euro, (iv) transferta neto me 172.1 milionë euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit tetor 2015, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 96,289.5 miliardë lekë krahasuar me muajin tetor të vitit 2014. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 57,945.5 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 38,344.0 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.



Në muajin tetor 2015, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 6,738.6 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin shtator 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin tetor 2015 arriti në 548,141.1 miliardë lekë. Teprica së kredisë, krahasuar me tetor 2014 shënoi rënie me vlerë -9,404 miliardë lekë, pra rënie prej rreth -1.7 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 56.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 310,579 milionë lekë.

Gjatë muajit tetor 2015, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.7 për qind ose 360,357 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 27.32 për qind ose 153,028 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.70 dhe 1.48 për qind apo 25,780 dhe 8,092 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin tetor 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 54.30 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 34.61 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.49 për qind dhe rreth 22.80 për qind.



## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin tetor 2015 shënoi rënie prej -0.03 për qind krahasuar me muajin paraardhës shtator 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 225,028.5 milionë lekë në fund të muajit tetor 2015, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin tetor 2014 prej 1.25 për qind.

Fig-11




**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin tetor 2015, kanë pësuar rënie prej 3,006.5 milionë lekë në krahasim me muajin tetor 2014. Depozitat në valutë gjatë muajit tetor 2015 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.0 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 87.4 për qind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit tetor 2015, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.4 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.4 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.0 për qind dhe rreth 12.9 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.2 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 837,821.4 milionë lekë) të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (108,130.3 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (15,797.3 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (8,632.3 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,605.7 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



**Përberja e depozitave Tetor 2015**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit tetor 2015, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rënie prej -1,131.4 milionë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 1,717.9 milionë dhe të depozitave në lekë me rreth 2,849.3 milionë lekë.

# Sektori Fiskal


## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-tetor 2015 janë mbledhur rreth 313.3 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 331.5 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 277 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 38.7 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 55.2% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 97.2% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 94% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 96% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 86% të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 213.5 miliardë lekë (ose rreth 97.3% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 10.1 miliardë lekë (ose rreth 96.7% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 59.9 miliardë lekë (ose rreth 101.1% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 22.5 miliardë lekë (ose rreth 90.6% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 277 miliardë lekë, 59.2 miliardë lekë (21% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 30 miliardë lekë (11%) për interesat, 30.4 miliardë lekë (11%) për shpenzime



operative dhe mirëmbajtje, 1.5 miliardë lekë (0.5%) për subvencione, 114.4 miliardë lekë (41%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 25.4 miliardë lekë (9.2%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 16.3 miliardë lekë (5.9%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 79% (shpenzime personeli), 73% (shpenzime për interesat), 73% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 83% (subvencione), 80% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 63% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 66% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 61%, ndërsa financimi i huaj është 57% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-tetor 2015 ishin rreth 313.3 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 283.5 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 22.5 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë periudhës janar-tetor 2015 (mld Lekë)

Burimi (Source)	tet'15 Oct'15	tet'14 Oct'14	Ndrysh(% Chang (%)
TVSH (VAT)	102.6	103.4	-0.8
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	19.7	17.6	11.9
Taksa doganore (Custom Tax)	4.7	4.8	-2.1
Taksat nacionale (National Tax)	28.4	27.1	4.8
Akcizat (Excise)	32.6	34.1	-4.4
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	24.2	22.7	6.6

*Burimi:* Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: tetor – 2015;

*Source:* Ministry of Finance, Fiscal Statistics: October – 2015;

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 18.2 miliardë lekë, për periudhën janar-tetor 2015, u mbështet nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 163% të totalit të deficitit) dhe nëpërmjet huasë afat-gjatë të huaj (rreth 55% të totalit të deficitit).

Për muajin tetor 2015, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32,393 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 32,947 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin tetor 2015, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 30 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.7 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1		Indeksi i Çmimeve të Konsumit Consumer Price Index																	
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
Janar	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	1.4	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	January
Shkurt	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	February
Mars	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	1.4	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	0.42	0.60	0.58	0.55	0.53	0.9	3.7	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	April
Maj	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	0.10	0.26	0.32	0.24	0.20	0.4	3.3	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	May
Qershor	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05	0.1	3.2	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	June
Korrik	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	-0.10	-0.07	0.08	-0.03	-0.04	0.2	3.4	3.6	2.7	1.6	1.8	1.3	July
Gusht	0.8	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.01	-0.02	0.12	-0.04	-0.03	0.1	3.5	3.1	2.8	1.2	2.0	2.0	August
Shtator	0.7	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6	0.09	0.02	0.13	0.06	0.01	0.2	3.4	2.8	2.6	1.7	1.5	2.3	September
<b>Tetor</b>	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1	<b>0.01</b>	0.10	0.06	0.14	0.05	0.02	<b>0.2</b>	3.0	3.0	2.4	1.7	1.4	<b>2.1</b>	<b>October</b>
Nëntor	0.2	0.1	0.2	-0.5	-0.2		0.11	0.06	0.14	0.01	0.00		2.8	2.9	2.5	1.0	1.7		November
Dhjetor	2.2	1.0	0.9	1.7	0.7		0.28	0.14	0.20	0.15	0.06		3.4	1.7	2.4	1.9	0.7		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source: INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2		Kursi i këmbimit Exchange rate Lekë për njësi të monedhës së huaj (Lek per unit of foreign currency)															
Monedha	2010	2011	2012	2013	2014	2015										Currency	
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																	<i>Average of period</i>
USD	103.94	100.90	108.18	105.67	113.64	120.73	123.46	129.66	129.97	126.19	125.61	126.99	125.39	124.19	124.21		USD
EURO	137.79	140.33	139.04	140.27	140.11	140.04	140.23	140.41	140.26	140.82	140.82	139.85	139.59	139.52	139.53		EURO
<i>Fundi i periudhës</i>																	<i>In the end of period</i>
USD	104.00	107.54	105.85	101.86	115.23	123.35	124.96	130.63	125.61	128.48	125.57	127.49	124.63	124.24	126.43		USD
EURO	138.77	138.93	139.59	140.20	140.14	139.72	140.36	140.34	140.53	140.98	140.29	139.59	139.73	139.39	139.18		EURO

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e Interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015										In percent	
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct		
<b>Norma e depozitave</b>																	Deposits rates
12-M	6.07	5.87	5.38	4.17	1.51	1.42	1.57	1.46	1.45	1.59	1.45	1.42	1.04	1.27	1.34	1.34	12-M
6-M	5.16	4.87	4.50	3.40	1.16	1.22	1.25	1.08	1.05	1.13	1.09	1.06	1.14	1.01	1.05	1.05	6-M
3-M	4.42	4.22	3.83	2.72	0.83	0.77	0.90	0.72	0.79	0.89	0.71	0.70	0.72	0.69	0.67	0.67	3-M
1-M	4.70	4.39	3.62	2.79	1.47	1.52	1.51	1.42	1.59	1.59	1.62	1.38	1.35	1.32	1.38	1.38	1-M
<b>Norma e huasë</b>																	Lending rates
12-M	11.52	11.17	10.28	9.52	7.00	7.76	7.36	8.74	8.14	7.98	8.85	7.62	7.60	8.50	7.11	7.11	12-M
6-M	11.69	12.28	10.61	9.59	8.18	8.21	8.17	9.30	10.18	8.86	9.28	7.49	8.28	8.11	9.81	9.81	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>																	Securities rates
Bono thesari 1/																	Treasury bills 1/
3-M	5.29	5.31	5.03	3.40	3.15	3.23	3.19	3.11	3.00	2.90	2.79	2.71	2.66	2.61	2.57	2.57	3-M
6-M	6.41	6.23	5.65	3.54	3.16	3.23	3.23	3.25	3.14	3.11	3.04	2.97	2.90	2.87	2.82	2.82	6-M
12-M	7.09	6.95	6.37	3.66	3.33	3.50	3.58	3.59	3.50	3.42	3.29	3.24	3.22	3.21	3.18	3.18	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>25,846</b>	<b>51,337</b>	<b>86,742</b>	<b>121,119</b>	<b>151,463</b>	<b>182,326</b>	<b>215,495</b>	<b>247,882</b>	<b>280,911</b>	<b>313,303</b>	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	256	915	1,703	2,587	3,450	3,793	5,057	5,545	6,294	7,298	Grants
II.	Të ardhura tatimore	22,921	46,273	75,905	105,522	133,076	161,396	191,952	222,825	253,572	283,525	Tax Revenue
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>15,656</b>	<b>33,322</b>	<b>56,377</b>	<b>76,893</b>	<b>98,178</b>	<b>120,206</b>	<b>143,514</b>	<b>167,547</b>	<b>191,359</b>	<b>213,512</b>	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Verëën e Shtuar	9,371	18,371	26,976	36,927	47,171	57,981	69,313	80,235	90,854	102,615	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	588	2,243	8,915	10,279	11,778	13,595	15,278	16,682	18,306	19,709	Profit Tax
3	Akcizat	1,779	4,359	7,056	10,598	13,904	17,407	21,316	25,948	29,528	32,649	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,934	3,932	6,087	8,582	11,262	13,551	16,404	19,681	23,119	25,396	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	1,635	3,673	6,068	8,820	11,924	15,031	18,037	21,281	25,355	28,409	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	349	744	1,275	1,687	2,139	2,641	3,166	3,720	4,197	4,734	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>549</b>	<b>1,386</b>	<b>2,513</b>	<b>4,972</b>	<b>5,783</b>	<b>6,732</b>	<b>7,289</b>	<b>8,567</b>	<b>9,440</b>	<b>10,115</b>	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	388	935	1,921	2,101	2,399	2,589	2,826	3,150	3,413	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	14	276	363	628	730	839	842	1,550	1,715	1,789	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	340	722	1,215	2,423	2,952	3,494	3,858	4,191	4,575	4,913	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>6,716</b>	<b>11,565</b>	<b>17,015</b>	<b>23,857</b>	<b>29,115</b>	<b>34,458</b>	<b>41,149</b>	<b>46,711</b>	<b>52,772</b>	<b>59,898</b>	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	5,626	9,961	14,568	20,143	24,582	29,011	34,574	39,207	44,319	50,527	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	951	1,296	1,951	2,831	3,647	4,416	5,400	6,118	6,873	7,624	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	139	308	496	683	886	1,031	1,175	1,386	1,580	1,747	Revenues for property compensation
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,669</b>	<b>4,149</b>	<b>9,134</b>	<b>13,010</b>	<b>14,937</b>	<b>17,137</b>	<b>18,486</b>	<b>19,512</b>	<b>21,045</b>	<b>22,480</b>	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				951	951	951	951	951	951	951	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,234	3,321	7,843	9,800	10,885	12,449	13,159	13,625	14,490	15,415	Income of budgetary institutions
3	Dividenti				444	449	461	480	518	518	521	Dividend
4	Tarifat shërbimeve	214	374	506	644	1,028	1,270	1,441	1,612	1,809	2,000	Tariffs on services
5	Të tjera	221	454	785	1,171	1,624	2,006	2,455	2,806	3,277	3,593	Other/not allocated
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>22,913</b>	<b>57,255</b>	<b>91,124</b>	<b>124,661</b>	<b>162,038</b>	<b>195,642</b>	<b>232,577</b>	<b>264,826</b>	<b>298,598</b>	<b>331,545</b>	TOTAL EXPENDITURE
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>21,098</b>	<b>46,432</b>	<b>74,883</b>	<b>102,855</b>	<b>131,965</b>	<b>162,187</b>	<b>193,330</b>	<b>221,745</b>	<b>249,471</b>	<b>276,987</b>	Current Expenditures
I.1	<b>Personell</b>	<b>5,474</b>	<b>11,301</b>	<b>17,303</b>	<b>23,115</b>	<b>29,084</b>	<b>35,027</b>	<b>41,185</b>	<b>47,240</b>	<b>53,196</b>	<b>59,188</b>	Personnel expenditures
1	Paga	4,764	9,767	14,873	19,905	25,021	30,135	35,464	40,684	45,820	50,996	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	710	1,534	2,430	3,210	4,063	4,892	5,721	6,556	7,376	8,192	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>2,984</b>	<b>6,294</b>	<b>8,937</b>	<b>11,822</b>	<b>14,499</b>	<b>17,184</b>	<b>22,058</b>	<b>24,928</b>	<b>27,243</b>	<b>29,926</b>	Interest
1	Të Brendshme	2,606	5,354	7,475	9,693	11,965	14,141	16,550	18,903	20,741	22,783	Domestic
2	Të Huaja	378	940	1,462	2,129	2,534	3,043	5,508	6,025	6,502	7,143	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>882</b>	<b>2,927</b>	<b>6,445</b>	<b>9,492</b>	<b>12,469</b>	<b>17,274</b>	<b>21,133</b>	<b>23,806</b>	<b>27,339</b>	<b>30,368</b>	Operational & Maintenance
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>53</b>	<b>122</b>	<b>301</b>	<b>363</b>	<b>628</b>	<b>810</b>	<b>985</b>	<b>1,106</b>	<b>1,233</b>	<b>1,461</b>	Subsidies
I.6	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>9,875</b>	<b>20,382</b>	<b>31,634</b>	<b>42,800</b>	<b>54,270</b>	<b>65,979</b>	<b>77,917</b>	<b>91,014</b>	<b>102,803</b>	<b>114,379</b>	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	7,874	15,911	24,449	32,938	41,522	50,586	59,557	69,088	78,174	86,953	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,001	4,471	6,965	9,631	12,517	15,162	18,129	20,871	23,574	26,264	Health insurance
3	Fondi i kompensimit te pronareve			220	231	231	231	231	1,055	1,055	1,162	Expenditures for Owners Compensation
I.7	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>1,127</b>	<b>3,239</b>	<b>5,664</b>	<b>8,722</b>	<b>12,467</b>	<b>16,276</b>	<b>19,066</b>	<b>21,136</b>	<b>23,246</b>	<b>25,414</b>	Local budget expenditure
I.8	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>703</b>	<b>2,167</b>	<b>4,599</b>	<b>6,541</b>	<b>8,548</b>	<b>9,637</b>	<b>10,986</b>	<b>12,515</b>	<b>14,411</b>	<b>16,251</b>	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	116	174	229	280	330	378	426	474	522	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	655	2,080	3,714	5,506	7,403	9,718	12,119	14,577	17,025	19,471	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-11	-29	711	806	865	1,389	1,389	1,512	1,512	1,512	Compensation for ex-political prisoners
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>8,830</b>	<b>14,215</b>	<b>17,953</b>	<b>20,894</b>	<b>25,457</b>	<b>28,619</b>	<b>34,028</b>	<b>38,745</b>	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	102	925	4,568	8,275	10,508	12,528	14,299	15,771	19,124	21,497	Domestically financed
2	Financimi Huaj	1,482	2,644	4,262	5,940	7,445	8,366	11,158	12,848	14,904	17,248	Foreign financing
IV.	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>231</b>	<b>7,254</b>	<b>7,411</b>	<b>7,591</b>	<b>12,120</b>	<b>12,561</b>	<b>13,790</b>	<b>14,462</b>	<b>15,099</b>	<b>15,813</b>	Arrears
1	Detyrimet e infrastruktures	211	4,668	4,762	4,886	5,242	5,299	5,554	5,579	5,596	5,862	Infrastructure - Arrears
2	Detyrimet tatimore					4,168	4,481	4,517	4,776	5,218	5,489	Tax - Arrears
3	Të tjera	20	2,586	2,649	2,705	2,710	2,781	3,719	4,107	4,285	4,462	Others
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>2,933</b>	<b>-5,918</b>	<b>-4,382</b>	<b>-3,542</b>	<b>-10,575</b>	<b>-13,316</b>	<b>-17,082</b>	<b>-16,944</b>	<b>-17,687</b>	<b>-18,242</b>	CASH BALANCE
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,933</b>	<b>5,918</b>	<b>4,382</b>	<b>3,542</b>	<b>10,575</b>	<b>13,316</b>	<b>17,082</b>	<b>16,944</b>	<b>17,687</b>	<b>18,242</b>	CASH BALANCE FINANCING
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-3,988</b>	<b>-3,093</b>	<b>-4,660</b>	<b>-802</b>	<b>1,788</b>	<b>5,979</b>	<b>-25,744</b>	<b>-26,251</b>	<b>-25,679</b>	<b>-24,126</b>	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	4	36	84	90	250	358	382	643	713	802	Privatization receipts
2	Hua-marje e brendshme	4,868	5,441	9,153	12,300	11,716	13,516	20,143	20,417	26,073	29,783	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	4,877	5,452	9,072	12,227	11,624	13,426	20,061	20,338	25,978	29,687	Other
2.2	Lokale	-9	-11	81	73	92	90	82	79	95	96	Foreign
3	Të tjera	-8,860	-8,570	-13,897	-12,992	-10,178	-7,895	-46,269	-47,311	-52,465	-54,711	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-8,020	-6,497	-10,828	-9,941	-6,325	-5,173	-43,836	-45,035	-49,625	-52,092	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-840	-1,803	-3,066	-3,056	-3,849	-2,721	-2,432	-2,276	-2,838	-2,619	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	-735	-1,062	-1,456	-1,800	-1,130	405	1,162	Deposits of Social and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	13	-171	1,264	-154	-407	-343	-215	-382	-159	-292	Preservation stock
8	Nënhua	58	118	118	394	442	451	495	663	676	799	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	3,676	3,631	3,753	3,449	3,856	3,484	3,172	2,790	3,117	-3,396	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-237	195	-81	117	138	231	285	262	309	351	Other-Float
V.3	<b>I huaj</b>	<b>1,055</b>	<b>9,011</b>	<b>9,042</b>	<b>4,144</b>	<b>8,787</b>	<b>7,337</b>	<b>42,826</b>	<b>43,195</b>	<b>43,366</b>	<b>42,368</b>	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,223	1,771	2,840	3,298	3,739	4,038	5,627	7,011	8,980	10,098	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	406	413	845	981	983	1,059	1,201	1,544	1,979	2,085	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	6	-34	-254	96	301	601	541	360	-286	-40	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	-8,170	-9,281	-11,330	-12,268	-13,102	-14,254	-16,616	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	665	8920	8920	8920	14028	14028	48926	48926	48,926	48926	Budgetary Support

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2015

Table of investments 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>102</b>	<b>925</b>	<b>4,568</b>	<b>8,275</b>	<b>10,508</b>	<b>12,528</b>	<b>14,299</b>	<b>15,771</b>	<b>19,124</b>	<b>21,497</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	6.44	25.93	51.73	58.21	58.53	59.96	56.17	55.11	56.20	55.48	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,482</b>	<b>2,644</b>	<b>4,262</b>	<b>5,940</b>	<b>7,445</b>	<b>8,366</b>	<b>11,158</b>	<b>12,848</b>	<b>14,904</b>	<b>17,248</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	93.56	74.07	48.27	41.79	41.47	40.04	43.83	44.89	43.80	44.52	In %
<b>Totali</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>8,830</b>	<b>14,215</b>	<b>17,953</b>	<b>20,894</b>	<b>25,457</b>	<b>28,619</b>	<b>34,028</b>	<b>38,745</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

## TË ARDHURAT DOGANORE 2015 (CUSTOMS REVENUES 2015)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	January	Feb	Mar	April	May	June	July	Agust	September	Oct	
Taksë doganore	349	744	1,275	1,687	2,255	2,641	3,167	3,720	4,198	4,734	Customs Duties
TVSH	5,805	12,386	20,043	27,489	38,183	43,564	52,550	60,795	68,800	77,683	V.A.T
Akcizë	1,779	4,359	7,056	10,598	12,499	17,407	21,316	25,948	29,528	32,649	Excises
Të tjera	209	412	652	946	3,450	1,908	2,341	2,660	3,042	3,357	Others
Renta Minerare	201	396	626	911	3,099	1,855	2,279	2,592	2,973	3,288	
<b>TOTALI</b>	<b>8,142</b>	<b>17,901</b>	<b>29,026</b>	<b>40,720</b>	<b>56,387</b>	<b>65,520</b>	<b>79,374</b>	<b>93,123</b>	<b>105,568</b>	<b>118,423</b>	<b>Total</b>

## TË ARDHURAT TATIMORE 2015 (TAX REVENUE )

TVSH	4,091	6,503	7,451	9,424	12,177	14,392	16,744	19,406	22,014	24,896	V.A.T
Akciza	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	Excises
Tatim mbi fitimin	393	2,051	8,715	10,279	9,477	13,595	15,291	16,682	18,306	19,709	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,919	3,997	6,120	8,607	10,902	13,510	16,320	19,554	21,967	24,249	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,225	3,128	5,351	8,073	9,419	13,428	16,061	19,083	22,285	25,052	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>7,628</b>	<b>15,679</b>	<b>27,637</b>	<b>36,383</b>	<b>41,976</b>	<b>54,925</b>	<b>64,416</b>	<b>74,725</b>	<b>84,572</b>	<b>93,906</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>15,770</b>	<b>33,580</b>	<b>56,663</b>	<b>77,103</b>	<b>98,363</b>	<b>120,445</b>	<b>143,790</b>	<b>167,848</b>	<b>190,140</b>	<b>212,329</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2015

The Deficit and Its Financing for 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qersh June	Korrik July	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct	
